

Nr Pr. 49/22
dt. 06.09.17

Raport për vlerësimin në kuadër të procesit të verifikimit të plotësimit të kushteve (Follow-Up)

për programin Bsc në “Dizajn”, të kërkuar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Programi i studimit, Bsc në “Dizajn” është Akredituar me kusht sipas Urdhërit të MAS Nr 439, datë 25.08.2016 “Për Akreditimin me kusht të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Dizajn” në Fakultetin të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, të Universitetit Privat “Albanian University”, mbështetur në VKA Nr 177, datë 07.07.2016

Më datë 10.11.2016, me shkresë nr 390/2 prot, Universiteti Privat “Albanian University” paraqet pranë Aplikimin për fillimin e procesit të heqjes së kushteve për programet Bsc “Anglisht” dhe Bsc “Dizajn”. Ky aplikim nuk shoqërohet me dokumentacionin përkatës.

Më datë 23.01.2017 Universiteti Privat “Albanian University”, paraqet pranë APAAL shkresën me Nr. 26 prot, datë 23.01.2017, “Dorëzim dokumentacioni”. Bashkëngjitur kërkesës, Institucioni ka paraqitur dokumentacionin mbi plotësimin e kushteve për këtë program studimi.

Më datë 21.03.2017 nëpërmjet sistemit AMS, i është kërkuar Institucionit plotësimi i dokumentacionit për të bërë të mundur vlerësimin teknik të programit dhe më pas vlerësimin në përmbajtje nga Eksperti. Më datë 03.05.2017 Institucioni paraqet plotësimin e dokumentacionit zyrtarisht por edhe nëpërmjet sistemit AMS.

Më datë 26.04.2017 është kryer vizita në Universitetin Privat “Albanian University”, sipas agjendës të përgatitur me ekspertin e vlerësimin të jashtëm dhe të dërguar në AU zyrtarisht por edhe si njoftim nëpërmjet sistemit AMS

Më poshtë paraqitet raporti i vlerësimin teknik dhe në përmbajtje në lidhje me shkallën e përmbushjes së kushteve të vendosura në VKA Nr 177 datë 07.07.2016, dokumentacionin që ka paraqitur Institucioni dhe masat që ka marrë për plotësimin e kushteve. Vlerësimi i Ekspertit të Jashtëm bazohet në këtë dokumentacion dhe vizitën në Institucion.

| Kushtet e vendosura në VKA Nr. 177, datë 07.07.2016 | Vlerësimi Teknik | Vlerësimi i Ekspertit |
|---|--|---|
| a. Të sigurojë që titullarët e lëndëve të jenë në masën më të madhë personel akademik | Në përmbushje të këtij kushti, AU deklaron se ka rekrutuar staf akademik të brendshëm dhe të jashtëm me grada shkencore “Doktor” dhe “Profesor I Asociar” të cilët mbulojnë ngarkesën më të madhe të orëve mësimore. Janë paraqitur ngarkesa | Në përmbushje të kushteve të vendosura AU ka deklaruar se ka rekrutuar staf akademike të brendshëm dhe të jashtëm me grada shkencore “Doktor” dhe “Profesor I Asociar”, |

| | | |
|---|---|--|
| <p>efektiv dhe të zotërojnë së paku gradën shkencore “Doktor”</p> | <p>mësimore e stafit për vitet akademike 2015-2016 dhe 2016-2017, CV e personelit si dhe kontratat dhe aneks kontratat e pedagogëve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.</p> <p><u>Koment dhe vlerësimi teknik</u></p> <p>Nga të dhënat e paraqitura si plotësim I dokumentacionit, rezulton se:</p> <p>Institucioni ka paraqitur ngarkesën mësimore të stafit me koeficient dhe pa koeficient. Për këtë arsye, nëpërmjet shërbimit iu kërkua koordinatores së institucionit shpjegime në lidhje me paraqitjen e këtyre ngarkesave. Përgjigja ishte: <i>... ngarkesa mësimore me koeficient i përket ngarkesës së normuar sipas Udhëzimit Nr.20, datë 09.05.2008, ndërsa ngarkesa pa koeficient është ngarkesa reale në auditor sipas kurrikulës. Për këtë arsye, vlerësimi për këtë pikë do të bazohet në të dhënat e ngarkesës mësimore pa koeficient</i></p> <p>Stafi akademik me kohë të plotë i Departamentit të Arkitekturës, për vitin akademik 2016-2017, I angazhuar në mësime ndihënien e këtij program studimi (semestri I parë dhe semestri I dytë) paraqitet 11 gjithsej: 1 Prof Dr; 1 Akademik I asociuar; 4 Dr dhe 5 Msc. Rezulton se Dr Silvana Sukaj është paraqitur edhe si staf I brendshëm edhe si staf I jashtëm. Institucioni deklaron se kjo pedagoge ka qënë fillimisht me kohë të plotë dhe më pas, gjatë këtij viti, ka kaluar më kohë të pjesshme.</p> <p>Për këtë arsye, aktualisht ngarkesa mësimore e këtij programi studimi mbulohet nga 10 pedagogë të brendshëm (1 Prof; 1 Akademik I asociuar; 3 Dr dhe 5 Msc)</p> | <p>duke paraqitur ngarkesën e tyre të orëve mësimore të stafit për vitet akademike 2015-2016 dhe 2016-2017, CV e personelit si dhe kontratat dhe aneks kontratat e pedagogëve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.</p> <p><u>Koment dhe vlerësimi Ekspertit</u></p> <p>Nga dokumentat e paraqitura nga AU janë paraqitur ngarkesa e stafit akademike me koeficient dhe pa koeficient të programit të studimit Bachelor në “Dizajn” të 2016 – 2017 si dhe 2015 – 2016 ku paraqiten për semestrin e parë dhe semestri e dytë 11 staf akademik efektiv: 1 Prof Dr; 1 Akademik I asociuar; 4 Dr dhe 5 Msc.</p> <p>Ndërkohë, evidentohet një lëvizje nga staf i brendshëm në staf i jashtëm, ku dhe vetë sipas vizitës së kryer në datë 21.07.2017 personat përgjegjës deklaruan lëvizjen nga pedagog fillimisht me kohë të plotë në kohë të pjesshme (Ngarkesa Mësimore Vjetore 2016-2017), gjë që impakton në ngarkesën mësimore të këtij programi studimi i cili reflektohet në 10 pedagogë të brendshëm (1 Prof; 1 Akademik I asociuar; 3 Dr dhe 5 Msc).</p> <p>Në disa raste vihet re se ka mospërputhje të profilit të stafit të rekrutuar me grada dhe lëndëve të cilët ata drejtojnë në programin e</p> |
|---|---|--|



| | <p>Rezultoni se sërish titullarë lënde me Msc janë 50% e gjithë stafit efektiv.</p> <p>Për të gjithë vitin akademik, ngarkesa mësimore e cila mbulohe nga stafi akademik me kohë të plotë është gjithsej 1373 orë ose 78%. Ngarkesa mësimore e cila mbulohe me staf akademik me kohë të pjesshme është 377 orë ose 22%</p> <p>Stafi akademik me kohë të pjesshme i Departamentit, i anagazhuar në mësimdhënien e këtij programi studimi, për semestrin e parë dhe për semestrin e dytë, viti akademik 2016-2017 është 9 gjithsej: 1 Prof As; 5 Dr; 2 Dr në proces (Dr Silvana Sukaj është llogaritur si e brendshëm për arsye se lënda “Grafikë” e cila mbulohe nga kjo pedagogë është dhënë në semestrin e parë të vitit 2016-2017</p> <p>Për të parë konkretisht masat që ka marrë institucioni për mbulimin e lëndëve me tituj dhe grada, janë krahasuar Plani mësimor nga RVJ dhe plani mësimor i deklaruar nga Institucioni për vitin akademik 2016-2017.</p> <table border="1" data-bbox="703 970 1469 1315"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Lëndët</th> <th>Pedagogu I RVJ</th> <th>Pedagogu i ndryshuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Art 3D</td> <td>Dr proces Olisa Ndrecka</td> <td>Dr Eranda shalsi/Msc Estela Kokolari (praktika)</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Interier Dizajn</td> <td>Msc Estela Kokolari</td> <td>Dr Eranda Shalsi</td> </tr> </tbody> </table> | Nr | Lëndët | Pedagogu I RVJ | Pedagogu i ndryshuar | 1 | Art 3D | Dr proces Olisa Ndrecka | Dr Eranda shalsi/Msc Estela Kokolari (praktika) | 2 | Interier Dizajn | Msc Estela Kokolari | Dr Eranda Shalsi | <p>studimit bachelor në “Dizajn”, si stafit të rekrutuar.</p> <p>Përsa i përket ngarkesës vjetore të stafit akademik të brendshëm në përputhje me aneks kontratat e firmosura dhe rolet e tyre në këtë department, duke ju referuar dhe ngarkesës së normuar sipas Udhëzimit Nr.20, date 09.05.2008, rezultoni se Drejtuesi Departamentit ka një ngarkesë në orët mësimore prej 397.5 orë për vitin akademik 2016 -2017, normë orësh e lartë përveç detyrave të tjera administrative të tijë që kryen në këtë institucion.</p> <p>Sipas dokumentave të paraqitura Stafi akademik me kohë të pjesshme i Departamentit, i anagazhuar në mësimdhënien e këtij programi studimi, për semestrin e parë dhe për semestrin e dytë, viti akademik 2016-2017 janë gjithsej 9: 1 Prof As; 5 Dr; 2 Dr në proces (1 pedagogë paraqitet si i brendshëm dhe i jashtëm).</p> <p>Ndërkohë në vizitën e kryer më datë 21.07.2017 në zyrën e Burimeve Njerezore rezultonte që Z. Arjan Zurbo (Lënda Pikturë Monumentale) ka marrë së fundmi titullin “Doktor i Shkencave” i cili duhet të</p> |
|----|--|-------------------------|---|----------------|----------------------|---|--------|-------------------------|---|---|-----------------|---------------------|------------------|---|
| Nr | Lëndët | Pedagogu I RVJ | Pedagogu i ndryshuar | | | | | | | | | | | |
| 1 | Art 3D | Dr proces Olisa Ndrecka | Dr Eranda shalsi/Msc Estela Kokolari (praktika) | | | | | | | | | | | |
| 2 | Interier Dizajn | Msc Estela Kokolari | Dr Eranda Shalsi | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | |
|--|---|---|----------------------------|---|---|--|
| | 3 | Njohje projekti | Dr proces Olisa Ndreçka | Dr Eranda Shalsi | <p>reflektohet, dhe përkthehet në 1 Prof As; 6 Dr; 1 Dr në proces.</p> <p>Pavarsisht ndryshimeve të ndërmarra nga institucioni rezulton se ka lëndë ku titullar ka pedagogë me kualifikimin Msc si psh lëndët: Vizatim i detajuar (praktika); Vizatim bashkëkohor (Praktika); Multimedia; Fotografia (praktika); Arti Grafik i botimeve, Menaxhim Arti (praktika); Grafike (praktika) Kaligrafi; Ilustrimi, etj.</p> <p>Përsa i përket ngarkesës mësimore vjetore 2016 – 2017 të paraqitur për stafin akademik të brendshëm apo të jashtëm si dhe me pasyrimin e orëve mësimore për çdo pedagogë në aneks kontratat e tyre, ekziston një mosparaqitje e oreve dhe stafit të cilët ndjekin procesin e “Punimeve të Diplomave” të studentëve në programin Bachelor në “Dizajn”. Një e dhënë e cila ndryshon ngarkesën mësimore vjetore të përgjithshme dhe atë të çdo stafi akademik me kohë të plotë apo të pjesshëm.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga AU, si dhe nga vizita në Instiucion, konstatohet se ngarkesa e stafit të brendshëm është rreth 75% në viti akademik (këtu duke</p> | |
| | 4 | - Vizatim I detajuar - Vizatim bashkëkohor | Msc Bashkim Zahaj | Dr Eli Xoxa Msc Bashkim Zahaj (praktikat) | | |
| | 5 | Pikturë monumentale | Dr proces Arjan Zurbo | Dr Eli Xoxa | | |
| | 6 | Gjuhë Angleze | Msc Zana Harxhi | Dr Sonila Daiu | | |
| | 7 | Menaxhim Arti | Dr proces Holta Arapi | Prof. dr Hivzi Muharremaj | | |
| | 8 | Grafikë | Dr proces Holta Arapi | Dr Silvana Sukaj | | |
| | <p>Nga krahasimi i këtyre dy planeve mësimore rezulton se disa lëndë që mbuloheshin nga pedagogë me Msc ose Dr ne process, në këtë vit akademik, 2016-2017 mbulohen nga pedagogë me titull Dr. Vërehet se ka pedagogë me titullin Dr që mbulojnë më shumë se dy lëndë.</p> <p>Me gjithë ndryshimet e bëra dhe masat që ka marrë institucioni, rezulton se ka lëndë që si titullar kanë pedagogë me kualifikimin Msc si psh lëndët: Vizatim I detajuar (praktika); Vizatim bashkëkohor (Praktika); Multimedia; Fotografia (praktika); Arti Grafik I botimeve, Kaligrafi; Ilustrimi, etj.</p> | | | | | |

| | | |
|--|---|--|
| | <p>Cv dhe kontratat e personelit akademik janë paraqitur pjesërisht. Mungojnë këto të dhëna për pedagogët: Bashkim Zahaj; Estela Kokalari; Arlind Dervishaj; Arjan Zurbo; Albana Vrap; Olisa Ndreçka.</p> <p>Kontratat e paraqitura janë dy llojesh. Kontratat pa afat të lidhura më 27.02.2017 për një pedagog me kohë të plotë dhe të lidhur më 20.10.2016 për dy pedagogë me kohë të plotë.</p> <p>Të gjithë pedagogët e ytjerë për të cilët janë paraqitur kontratat dhe aneks kontratat afatin e kontratave e kanë semestrare (7 pedagogë) dhe 1 vjeçare (3 pedagogë)</p> <p>Nuk janë paraqitur leja nga punëdhënësi për personelin akademik me kohë të pjesshme.</p> <p>Dokumentacioni është pjesërisht I plotë.</p> | <p>Ilogaritur edhe ngarkesën që nuk pasqyrohet për mbulimin e punimit të diplomës nga stafi I brendshëm)</p> <p><u>Programi respekton në një masë të madhe standardet e kërkuara por ngelet problematike në disa raste përputhshmëria e formimit të lektorëve me lëndën / lëndët që ata mbulojnë.</u></p> |
| <p>b. Biblioteka të ketë izolimin e nevojshëm për zhvillimin e studimit në hapësirat e saj.</p> | <p>Në plotësim të këtij kushti, pas kërkesës për plotësim dokumentacioni, Institucioni deklaroi se ka bërë mbylljen fizike të pjesës të hollit, në gjysmë katin e të cilit është e pozicionuar salla e bibliotekës. Mbyllja është realizuar me strukturë druxham duke realizuar izolimin e sallës së studimit, bibliotekës/internetit.</p> <p>Institucioni ka paraqitur Planimetrinë e hollit me ndryshime; planimetrinë e bibliotekës/internet; foto të hollit kur funksiononte si bar dhe fotot të hollit me funksion sallë studimi me ndryshime.</p> <p>Dokumentacioni është I plotë.</p> | <p>Pas vizitës së kryer në datë 21.07.2017 dhe kërkesave të parashtuara më parë, “Abanian University” ka marrë gjithë masat e duhura për të plotësuar kushtet dhe realizuar izolimin e sallës së studimit, bibliotekës/internetit</p> <p>Dokumentacioni I paraqitur për këtë pikë është I plotë.</p> |



Janë paraqitur nga Institucioni stafi akademik I brendshëm dhe I jashtëm (emër mbiemër; grada; lëndët; ngarkesa) për semestrin e parë dhe semestrin e dytë të vitit akademik 2016-2017 dhe të vitit akademik 2015-2016. Janë paraqitur CV dhe kontratat e punës për disa pedagogë së bashku me aneks kontratat.

Janë paraqitur të dhëna për ndryshimet e bëra në hollin ku dikur shërbente si bar kafe; foto të hollit ekzistues si dhe planimetria me ndryshimet e bëra.

Konkluzion përfundimtar nga Eksperti i vlerësimit të jashtëm:

Programi respekton në një masë të madhe standardet e kërkuara por ngelet problematike në disa raste përputhshmëria e formimit të lektorëve me lëndën / lëndët që ata mbulojnë.

Mbi kërkesat e parashtruara më parë për izolimin e nevojshëm dhe zhvillimin e studimit në hapësirat e Bibliotekës në "Abanian University", konstatova se janë marrë të gjitha masat e duhura për të plotësuar kushtet dhe realizuar izolimin e sallës së studimit, bibliotekës/internetit

Ekspert i Vlerësimit të Jashtëm Dr. Sonia Jajiç

Gusht 2017

